



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Nr. 27-01/25
Data: 13.02.2026
Bujanoc

KRYEMINISTRIT TE REPUBLIKES SE KOSOVES

TELEGRAM URIMI

I nderuar z. Kryeministër Albin Kurti,

Në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar dhe të shqiptarëve të Luginës së Preshevës e Sanxhakut, Ju përcjell urimet më të përzemërta për zgjedhjen Tuaj në krye të Qeverisë së Republikës së Kosovës!

Zgjedhja e Juaj në drejtimin e ekzekutivit përfaqëson vazhdimësinë e një vizioni shtetformues dhe një përkushtimi të dëshmuar ndaj interesave kombëtare. Qeveria që Ju drejtoni ka shënuar një kthesë historike në raport me Luginën e Preshevës, duke e ngritur çështjen tonë në nivel institucional dhe duke ofruar mbështetje konkrete për të drejtat, zhvillimin dhe dinjitetin e shqiptarëve në këtë trevë.

Jam i bindur se nën udhëheqjen Tuaj, Republika e Kosovës do të vazhdojë të jetë shtyllë e fortë e unitetit dhe e avancimit kombëtar.

Ju uroj suksese në realizimin e përgjegjësiave Tuaja shtetërore!

Me respekt,

KRYETARI

Enkel Rexhepi

